



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura e III-të

Nr. 55/09

Prishtinë, më 1.07.2009, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: **Gani Koci, Kosara Nikolić, Safete Hadërgjonaj, Myrvete Pantina, Haki Shatri, Riza Smaka dhe Hajdin Abazi, Naser Osmani, Besa Gaxherri, Shkumbin Demaliaj, Müfera Şinik dhe Armend Zemaj.**

Nga stafi mbështetës i Komisionit: **Natasha Prica-Tisma, Vilson Ukaj, Dashurie Canolli, Fatmire Vojvoda (praktikante), Gazmend Avdyli (praktikant).**

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: **Lavdim Krasniqi Drejtor i IGJK-së, Nesrin Lushta kryetare e KQZ-së Xhelil Pajaziti, Xhemail Peçani nga KQZ , Edi Shukriu kryetare e KKTK-së ,monitorues nga Zyra e Presidentit, OSCE, ICO, KDI.**

Kryesues: Gani Koci, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja dt. 15.06.2009**
- 3. Shqyrtimi i Raportit vjetor Financiar të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2008**
I ftuar : Lavdim Krasniqi, Drejtor i IGJK –së;
- 4. Shqyrtimi i Raportit nr. 03/2374/ ra-015 dt. 16.06.2009 vjetor financiar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për periudhën 2008/2009**
E Ftuar : Nesrin Lushta , kryetare e KQZ – së;
- 5. Shqyrtimi i kërkesës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë për sigurimin e kushteve të punës së këtij Këshilli, nr. 03/2409/Do- 1505, dt.22.06.2009**
E ftuar: Edi Shukriu, kryetare e KKTK-së;
- 6. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.02/L-99 për Prokurimin Publik në Kosovë**
- 7. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendit ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja dt. 15.06.2009

Riza Smaka, theksoi se e ka lexuar me vëmendje procesverbalin dhe theksoi se ai është hartuar në mënyrë të shkëlqyer dhe kështu duhet hartuar procesverbalet. Sugjeroi kryetarin të nënshkruaj atë.

Kryesuesi, konstatoi se procesverbali nga mbledhja e kaluar dt. 15.06.2009, miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor Financiar të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2008

Lavdim Krasniqi, theksoi se gjatë vitit 2008 kemi filluar në implementimin e disa programeve të reja. Buxheti i Institutit në vitin e kaluar ka qenë 341,468 € ku pjesa më e madhe e tij është shpenzuar për mallra dhe shërbime, ndërsa për shkak të numrit të vogël të punëtorëve është shpenzuar më pak për paga dhe meditare, ndërsa në anën tjetër kemi arritur që të kufizojmë shpenzimet komunale. Shprehur në përqindje buxheti është shpenzuar 90.7%. Një pjesë e shpenzimeve është mbuluar nga donacionet (USAID, UNDP), si rezultat i së cilës ka ndikuar që mjetet e pashpenzuara të kthehen në buxhetin e Kosovës. Ndërsa nuk kemi pasur lëvizje të stafit.

Safete Hadërgjonaj, vlerësoi raportin mirë të hartuar. Megjithatë theksoi se shpenzimet e bëra për pagesën e qirasë janë të larta. Ndërsa sa i përket shërbimeve kontraktuese shifet se në vitin 2008 keni një rritje të dukshme krahasuar me vitin 2007, ndoshta brenda këtyre shërbimeve janë përfshirë edhe shpenzimet për trajnime. Do të ishte mirë që për “shpenzimet tjera” në vlerë prej 17.175€ të jepeshin sqarime më të detalizuara.

Armend Zemaj, duke komentuar çështjen e mëditjeve, pyeti sa paguhen anëtarët e Këshillit drejtues?

Riza Smaka, vlerësoi rolin e funksionimit të Institutit Gjyqësor në këtë fazë, kur po bëhen ndryshime rapide në rendin juridik, dhe në këtë drejtim stafi i gjyqësorit ka nevojë për trajnime. Sugjeroi që me një rregullore të caktohen disa normativa apo kritere për kompenzimin e punës së trajnerëve. Gjithashtu sugjeroi që përfaqësuesit e IGJK-së, në ato çështje që nuk janë të rregulluar, të propozojnë ndryshime apo plotësime ligjore, që do të ishin në dobi të funksionimit më të mirë të punës së këtij Instituti.

Hajdin Abazi, theksoi se shpenzimet e bëra për trajnime janë të larta. Nëse me këto mjete po trajnohen gjyqtarët, rezultatet po vërehen shumë pak në praktikë, kur dihet edhe fakti se pengesat më të mëdha në luftën kundër korrupsioni dhe krimin, po shfaqen në sistemin gjyqësor.

Myrvete Pantina, theksoi se nëse krahasohet periudha nga viti 2006 - 2008, shifet se kemi një diferencë të madhe të rritjes së qirasë. Lidhur me këtë pyeti pse ka ndodhur ky ndryshim kaq i madh?

Lavdim Krasniqi, theksoi se arsyeja e rritjes së shërbimeve kontraktuese, ka të bëjë me rritjen e programeve të reja, për çka është dashur të angazhohmë punëtorë shtesë. Sa i përket pagesës së mëditjeve, kjo bëhet konform Udhëzimit Administrativ të nxjerrur nga Zyra e Kryeministrit, dhe bëhet në shuma fikse. Çështjet që nuk janë të rregulluar me ligj, janë të parapara me statut dhe rregullore. Sa i përket qirasë, në vitin 2006 kemi qenë në një ndërtesë publike, më pas ka ardhur kërkesa nga Qeveria që brenda një muaji të lëshojmë objektin dhe në muajin dhjetor jemi zhvendosur në objekt privat. Është edhe interes i yni që të kalojmë në objekt publik, për çka do të kemi edhe kursime në buxhet.

Kryesuesi, theksoi nga diskutimet shifet se raporti është i pranueshëm për komisionin, me vërejtjet që raporti i ardhshëm të jetë hartuar sipas formatit standarde të raportimit, në bazë të formularëve që ka përgatitur MEF-i.

Pasi vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Raporti financiar i Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2008 i plotëson standartet ligjore të kontabilitetit për raportim.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa i rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës që në seancën plenare, të miratojë Raportin financiar i Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2008.

4. Shqyrtimi i Raportit nr. 03/2374/ ra-015 dt. 16.06.2009 vjetor financiar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për periudhën 2008/2009

Kryesuesi, theksoi se raporti përmbush kushtet ligjore për raportim. Një vërejte që duhet përmendur ka të bëjë me atë se raporti thirret në Kushtetutë, ndërsa autorizimet KQZ-ja i merr edhe nga ligji.

Nesrin Lushta, pasi që këshilli i KQZ-së merret me profesionalisht me raportimin, i dha fjalën kryesuesit të tij, që të jap shpjegime më detale.

Xhelil Pajaziti, theksoi se gjatë vitit 2008 nuk kemi pasur probleme financiare, për katër muaj kemi vepruar në objektin e OSBE-së, dhe në këtë mënyrë kemi kursyer shpenzimet për qiranë. Problem paraqet çështja e moszgjidhjes së statusit të anëtarëve të përhershëm të KQZ-së. Për këtë çështje edhe Presidenti i ka rekomanduar në MEF që të paguhemi si anëtar të rregullt. KQZ-ja ka dy buxhete, një buxhet për sekretariatën dhe buxhetin zgjedhor, i cili është bartur këtë vit.

Kryesuesi, theksoi se çështja e përcaktimit të statusit të anëtarëve të buxhetit, duhet të rregullohet me ligjin për zgjedhjet dhe jo të vendos, Presidenti apo cilido institucion tjetër.

Safete Hadërgjonaj, vlerësoi raportin të përgatitur mirë, mirëpo theksoi se do të ishte më mirë që ai të përgatitej në bazë të formularëve standard të raportimit të parapara nga MEF-i. Nga analiza bërë raporti, shifet se shpenzimet kontraktuese janë të rritura, prandaj do kishte qenë mirë të jepej një sqarim për këto shpenzime. Një çështje tjetër ka të bëjë me faktin se disa shpenzime janë më të mëdha në krahasim me ato të planifikuar, për çka do të ishte mirë që të ketë një përputhje në mes buxhetit të planifikuar dhe atij të shpenzuar.

Riza Smaka, theksoi se raporti nuk përmbush standardet nevojshme të raportimit, do të duhej që ai të jetë i thjeshtë, i lexueshëm dhe i krahasueshëm. Një vërejte tjetër ka të bëjë me shumën e larta të shpenzimeve për kategorinë “mallra dhe shërbimet” dhe mungesa e specifikimeve të tyre. Më pas pyeti se a mund ta dijë sa është pagesa e anëtarit të KQZ-së?

Armend Zemaj, vlerësoi se do të ishte mirë që raporti ta kishte tabelën krahasuese. Për shkak të transparencës u interesua të dinte për mëditjet që marrin anëtarët e KQZ-së. Më pas pyeti, a keni menduar që me rastin e planifikimit të buxhetit, “fondi për demokratizim” të mos jetë pjesë e buxhetit të Kuvendit, por transferohet në kuadër të buxhetit të KQZ-së.

Besa Gaxherri, theksoi se raportit i mungon ana teknike standarde. Ndërsa për kategorinë “paga dhe mëditje”, do të kishte qenë mirë të ishte një raport plotësues, për të treguar sa janë pagat e stafit të

administratës. Nga raporti shifen devijime të shpenzimeve të planifikuara me ato të shpenzuara, rasti i shpenzimeve për paga, pastaj “shpenzimet arsimore dhe trajnuese”, nga 4.000 € të planifikuara i keni shpenzuar 99 € (kur dihet se kemi nevojë për këto shërbime pasi që po përgatitemi për zgjedhje). Mjetet e parapara për “hardwer për teknologji informative” nuk keni shpenzuar fare, për çka është e papranueshme kur dihet nevoja për këtë shërbim. Po ashtu nuk jepen sqarime për shpenzimet “Paisje tjera”, gjithashtu mungojnë sqarimet për “shpenzimet kontaktuese”. Ndërsa për shpenzimet “mobile dhe paisje” shifet se keni kursyer për çka është për tu vlerësuar. Në fund pyeti a keni planifikuar koston e zgjedhjeve lokale, dhe mundësisht të tregoni sa do të jetë ajo?

Xhelil Pajaziti, theksoi se do të përmisojmë anën teknike të përgatitjes së raportit. Në pyetjen e shërbimeve kontraktuese, KQZ-ja për shkak të veprimtarisë specifike, kryen edhe shërbime të këtilla. Sa i përket pagesës së anëtarëve të KQZ-së, më herët jemi paguar në bazë të një vendimi të PSSP-së, ndërsa me bartjen e kompetencave, kemi bërë kërkesë për zgjidhjen e problemit të pagave, dhe deri me tani nuk është bërë ndonjë zgjidhje dhe si duket Qeveria ka rënë dakord që të vazhdojë pagesa në formë të mëditjeve. Prandaj anëtarët janë paguar me mëditje prej 60€ dhe nuk ka mundur ta kalohet shumën 500€. Sa i përket fondit për demokratizim, në bazë të ligjit, KQZ-ja nuk është kompetent të vendosë për këtë çështje.

Xhemal Peqani, në përgjigjen e pyetjeve për shpenzimet e trajnimeve, theksoi se arsyeja e mosshpenzimit të këtyre mjeteve ka ndodhur, për shkak se trajnimet janë organizuara nga OSBE-ja. Ndërsa kursimi i shpenzimeve për mobile, ka ndodhur se mobilet ekzistuese i kemi transferuar në objektin që jemi tani. Çështja e hardwerit ka qenë planifikuar, por për shkak të sistemit të ndryshëm të numrit të votave kemi planifikuar ti blejmë këtë vit.

Myrvete Pantina, theksoi se nga përfaqësuesi i KQZ-së u theksua se kemi bërë kurse nga qiraja, ndërsa në raport shifet se mjetet e parapara për qira janë shpenzuar të gjitha. Lidhur me këtë kërkojë sqarime shtesë?

Shkumbin Demaliaj, theksoi se raporti është dërguar me vonesë në Kuvend. Pas analizimit të tij shifet se cilësia e stafit nuk duket adekuate dhe ka nevojë për trajnime. Duke pasur parasysh faktin se në zgjedhjet e vitit 2007, nuk kemi pasur shifra rreth procedurave të prokurimit për shtypjen e listave të fletëvotimit, dhe si subjekt politik dyshojmë se janë bërë manipulime në këtë drejtim. Andaj lidhur me këtë pyeti, a është përgatitur KQZ-ja për hapjen e procedurave të tenderimit për kompanitë që do të shtypin fletëvotimet në zgjedhjet lokale. A do ti organizojë zgjedhjet KQZ apo OSBE-ja?

Hajdin Abazi, theksoi nga raporti vërehet se kemi suficit të mjeteve. Ky është një lajm shqetësues, kur dihet se jemi në prag të zgjedhjeve lokale dhe do të duhej bëheshin të gjitha përgatitjet dhe duhet shmangur problemeve të mundshme për shkak të mungesës së mjeteve financiare. Prandaj buxhetin e miratuar nga Kuvendi, duhet shfrytëzuar në afatet e parapara.

Nesrin Lushta, theksoi se OSBE-ja nuk po monitoron KQZ-në, ajo ofron vetëm këshilla profesionale dhe mbështetje, dhe nuk ka asnjë influencë tjetër në KQZ.

Kryesuesi, vërejtjet dhe sugjerimet e bëra të ndikojnë në përmisimin e punës së KQZ-së dhe defektet të mos të përsëriten në të ardhmen. Përndryshe raporti përkrahet me sugjerimet që në të ardhmen të përgatitet në bazë të formularëve standard të parapara nga MEF-i.

Pasi vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Raporti financiar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për periudhën 2008/2009 i plotëson standartet ligjore të kontabilitetit për raportim.

- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa i rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës që në seancën plenare të miratojë Raportin financiar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për periudhën 2008/2009.

5. Shqyrtimi i kërkesës nr. 03/2409/Do- 1505, dt.22.06.2009 së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për sigurimin e kushteve të punës së këtij Këshilli

Kryesuesi, theksoi se Këshilli është themeluar në bazë të ligjit dhe anëtarët e këtij këshilli i ka zgjedhur Kuvendi, mirëpo puna e tyre nuk është funksionalizuar për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore. Prandaj e kemi për detyrë ti rekomandojmë Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, që në procesin e rishikimit të buxhetit për vitin 2009, të krijoj një kod të veçantë buxhetor dhe të parashihen mjete te nevojshme për funksionimin e këtij këshilli. Në përgatitjen e kërkesës së këshillit ka ndihmuar edhe administrata e Kuvendit, ku buxheti i këtij këshilli planifikuar për vitin 2009 dhe është prezantuar në formularët standard.

Edi Shukriu, njoftoi se anëtarët e këshillit janë nga Kuvendi, i cili ka bërë planin e punës dhe do të bëjmë planin nacional. Por për funksionalizimin e punës do të duhej të kemi mjete buxhetore, në mënyrë që të punësojmë stafin e administratës, dhe të mund të kryejmë detyrat tona siç janë të përcaktuar me ligj.

Kryesuesi, një çështje që do duhej të zgjidhej është se ku të vendoset si institucion, në cilën vijë buxhetore. Propozoi që të jetë si institucion i pavarur buxhetore, sikurse të gjitha agjencionet e pavarura dhe jo të mbetet në kuadër Kuvendit, për arsye se po fusim shumë programe dhe po del në opinion se Kuvendi po rritet buxhetin e vet. Sa i përket kërkesës buxhetore ka qenë minimumi i asaj që është kërkuar. Megjithatë kur është fjala të kërkesa për blerjen e një veture, ndoshta fillimisht do të ishte mirë që të huazohet një veturë nga Qeveria dhe mjetet e parapara të kursehen për fillim.

Besa Gaxherri, theksoi se duhet aprovuar kërkesa, përndryshe po që se shtyhet zgjidhja e këtij problemi, bëjmë shkelje ligjore, kur dihet se e kemi aprovuar ligjin dhe i kemi zgjedhur anëtarët e këtij këshilli në Kuvend. Sa i përket kërkesës për blerjen e veturës, propozoi që blihet një veturë më e lirë, e cila mund të jetë shumë e mirë në plotësimin e nevojave e këtij Këshilli, dhe më vonë të planifikohen blerja e veturave tjera, kur dihet se veprimtari e tij zhvillohet në teren. Sa i përket çështjes së përcaktimit të kodit buxhetor, propozoi që për fillim të parashihet si dikaster në kuadër të Ministrisë së Kulturës, por me kod të veçantë buxhetor. Përndryshe theksoi se është obligim i mazhorances te zgjidhë problemin e funksionimit të këtij Këshilli.

Kryesuesi, propozimin për vendosjen e këtij këshilli në cilëndo Ministri vlerësoi si jo të qëlluar, për arsye se po ndikohet në pavarësinë e këtyre institucioneve të pavarura.

Riza Smaka, theksoi se për fillim, ndoshta do te ishte zgjidhje e mirë këshilli të futet si nënkod buxhetor brenda Ministrisë së Kulturës. Përndryshe Këshilli ndoshta do të duhej të ketë statutin e Komiteti Ndërqeveritar sepse këtu ndërliiden po thajse të gjitha ministritë (kultura, shkenca, teknologjia, ambienti, etj.),dhe kjo formë praktikohet ne praktikat parlamentare të shteteve te përparuara. Më pas pyeti kryetaren e këshillit për statusin e anëtarëve, se a duhet të jetë permanent, të paguar apo emra. Me qëllim të kursimeve të mundshme, propozoi që sekretari te jetë njëkohësit udhëheqës ekzekutiv, që ndikon edhe në reduktimin e numrit të stafit civil.

Armend Zemaj, propozoi që në gjashtë muajt e këtij viti, deri në konsolidimin e tij, buxheti i këtij Këshilli të vendoset brenda Kuvendit të Kosovës, me program të veçantë buxhetor. Ndërsa me rastin e planifikimit të buxhetit për vitin 2010 të parashihet si organizatë e pavarur buxhetore. Duke pasur parasysh faktin se po aprovojmë buxhetin për gjithë vitin, për çka edhe do të ketë suficit, prandaj

është mirë që të jepet një fuqi brenda Kuvendit, që me rastin hapjes së konkursit, të bëhet përzgjedhja e ekspertëve më të mirë, që do të mund të ndihmonin në punën profesionale të Këshillit.

Kryesuesi, u pajtua me propozimin, që për gjashtë muajt e mbetur të këtij viti, Këshilli të mbetet brenda Kuvendit me kod të veçantë buxhetor, ndërsa në vitin 2010 të parashihet si organizatë e pavarur buxhetore.

Hajdin Abazi, theksoi se në kërkesën e këshillit kërkohen 71,000 € ndërsa letrën sqaruese të bërë nga departamenti i buxhetit të Kuvendit thuhet se kërkesa është 81,000 € prandaj do të ishte mirë dijmë se cilën po e aprovojmë.

Kryesuesi, në përgjigjen e parafolësit, objekt votimi do të jetë kërkesa e prezantuar në formularët standard, ku është bërë përlllogaritja për vitin 2009.

Safete Hadërgjonaj, theksoi se nëse shikojmë me kujdes kërkesën thuhet se janë 16 punëtor, ndërsa nëse numërohen shifet se janë 17 punëtor. Duke parë se mjetet janë planifikuar që nga janari i këtij viti, dhe mund të mbesin si suficit, theksoi se ndoshta është më mirë të reduktohet kërkesa dhe mjetet të parashihen për gjashtë muajt e mbetur të vitit.

Pasi vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni përkrahu kërkesën buxhetore të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore dhe i rekomandon Ministrisë për Ekonomi dhe Financa që në procesin e rishikimit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2009, kërkesën e Këshillit ta përfshijë si program të veçantë buxhetor në kuadër të Organizatës Buxhetore - Kuvendi.
- II. Në procesin planifikimit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2010, Komisioni i rekomandon Ministrisë për Ekonomi dhe Financa që Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore të përfshihet si Organizatë e pavarur Buxhetore.

6. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.02/L-99 për Prokurimin Publik në Kosovë

Kryesuesi, theksoi se projektligji i propozuar nuk përmbush kërkesat e plota të komisionit, që është kërkuar të hartohet një ligj të ri, në të cilin do të përfshiheshin edhe dy kaptina të reja. Njëra do të duhej të rregullonte çështjet e prokurimit publik për Misionet diplomatike, ndërsa tjetra çështjet e prokurimit publik për ndërmarrjet publike. Ndërsa me këtë projektligj kemi të përfshirë vetëm pjesën e prokurimit publik të misioneve diplomatike. Megjithatë propozoi që si të tillë të rekomandohet Kuvendit miratimi i tij në parim dhe më vonë të bëhen ndryshimet e nevojshme.

Pasi vërejtjeve të bëra, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. I rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës të miratojë në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-99 për Prokurimin Publik në Kosovë.

Mbledhja përfundoi në ora 13:00

Përgatitur nga

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit,

Gani KOCI